



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1400/3 prot.

Datë 23.06.2023

V E N D I M
Nr. 510/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës .06.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr. REF-72224-06-12-2023, me objekt “Kite dhe reagente”, me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-06-2023 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

Autoriteti Kontraktor: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.
Rruga “Bujar Bishanaku”, Shkodër

Ankimues: “Almedical” SHPK
Rruga ‘Shefqet Musaraj’, ND. nr. 17- Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-72224-06-12-2023, me objekt “Kite dhe reagente”, me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-06-2023 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

II.2. Në datën 19.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Almedical” SHPK, protokolluar me nr. 1400/2023 prot., datë 19.06.2023, duke kërkuar modifikimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Konkretisht ankimuesi, për reagentët e kërkuar në shtojcën 5 të DST:

<i>NR</i>	<i>Emertimi produktit</i>	<i>Specifikimet</i>
-----------	---------------------------	---------------------

9	DPDI (për klorin e lirë)	1. DPDI (për matjen e klorit të lirë në ujin e pijshëm) blister me tableta (1 tabletë e llogaritur për 1 analizë) për aparatën Lovibond 2000 dhe DPDI (për matjen e klorit të lirë me aparatën HANNA instrument) pluhur i ambalazhuar në qese letre të plastifikuar blister 4 copësh të paketuara në kuti kartoni të jetë e shënuar data e skadencës. Shenim : 1/3 e sasive se kërkuar nga AK duhet të ofertohej për aparatën Hanna dhe 2/3 e sasive për aparatën Lovibond 2000.
10	DPD3 (për klorin total)	1. DPD3 (për matjen e klorit total në ujin e pijshëm) blister me 10 tableta (1 tabletë e llogaritur për 1 analizë) për aparatën Lovibond dhe DPD3 (për matjen e klorit total me aparatën HANNA instrument) pluhur i ambalazhuar në qese letre të plastifikuar blister 4 copësh të paketuara në kuti kartoni të jetë e shënuar data e skadencës.
11	Phenol red (kufiri matës pH 6.4-9)	1. Phenol red (kufiri matës pH 6.4-9) në blistera 10 tabletash për aparatën Lovibond 2000. Në blister të jetë e shënuar data e skadencës.
18	Kyveta 10 ml (aparati Lovibond)	18.Kyveta 10 ml (aparati Lovibond) katrorë qelqi me brinjë 14 mm me lartësi 84 mm të shkallëzuara

për të cilët, AK në shtojcën 7, te Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/kualifikimit, pika 2.4.1 të DST ka kërkuar: **“Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar nga prodhuesi për shitje, tregtimin dhe suportin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara objekt i kontratës”, ka kërkuar të hiqet letra e autorizimit për këto produkte** pasi reagentët e mësipërm janë specifike për aparatën Lovibond 2000 dhe prodhohen vetëm nga kjo kompani. Në bazë të komunikimeve telefonike me prodhuesin Lovibond, na kanë konfirmuar që kanë distributor zyrtar në Shqipëri. Duke sjellë kështu kufizimin e konkurrencës së operatorëve ekonomik pjesëmarrës për këtë procedurë, pasi nuk mund të sigurojnë dot letrën e autorizimit nga ky prodhues, si dhe rrjedhimisht duke çuar në një fitues të vetëm të paracaktuar. Këto produkte janë lehtësisht të gjendshme nga distributorë të tjerë ndërkombëtarë, kështu që ne mund të bëjmë furnizimin e këtyre produkteve sipas specifikimeve që kërkon Autoriteti Kontraktor.

Gjithashtu **ankimuesi ka kërkuar heqjen e specifikimit teknik të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për artikullin e mëposhtëm:**

59	Letër filtri (50 cm x 50 cm)/ duhet të ketë aftësi të shpejtë filtruese e gradës së katërt me masë poresh 20-25 mikron
----	--

Ky artikull gjendet në disa kompanitë ndryshme me përmasat (50cmx50 cm), por specifikimet teknike të kërkuar (duhet të ketë aftësi të shpejtë filtruese e gradës së katërt me masë poresh 20-25 mikron) nuk përshatën me përmasat e filtrit.

Ndaj kërkojmë nga KSHA:

- Pranimin e ankesës tonë
- Modifikimin e kritereit dhe specifitimeve teknike të sipërshënuara.”

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr.694/4 prot., datë 20.06.2023 protokolluar me tonën nr. 1400/2 prot., datë 22.06.2023, me objekt “Përcjellje” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi Nr.694/3 prot. Datë 20.06.2023 i autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës, së operatorit ekonomik ankimues, i cili ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës duke u shprehur se: “Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ana juaj dhe kryerjes së verifikimeve të nevojshme për këtë rast, AK vendos pranimin e plotë të ankesës së bërë nga ana juaj.”

II.5. Konkretisht, referuar informacioni më sipër konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës si më poshtë vijon:

- Në lidhje me pretendimin tuaj për pikën 2.4.1 të kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes /kualifikimit në lidhje me pikat 9,10,11 dhe 18 si më poshtë:

(9)DPD1 (për matjen e klorit të lirë në ujin e pijshëm) blister me tableta (1 tabletë e llogaritur për 1 analizë) për aparatën Lovibond 2000 dhe DPD1 (për matjen e klorit të lire me aparatën HANNA instrument) pluhur i ambalazhuar në qese letre të plastifikuar blister 4 copësh të paketuara në kuti kartoni të jetë e shënuar data e skadencës. Shenim : 1/3 e saise se kerkuar nga AK duhet te ofertothen per aparatën Hanna dhe 2/3 e sasie per aparatën Lovibond 2000

(10) DPD3 (për matjen e klorit total në ujin e pijshëm) blister me 10 tableta (1 tabletë e llogaritur për 1 analizë) për aparatën Lovibond dhe DPD3 (për matjen e klorit total me aparatën HANNA instrument) pluhur I ambalazhuar në qese letre të plastifikuar blister 4 copësh të paketuara në kuti kartoni të jetë e shënuar data e skadencës.

(11)Phenol red (kufiri matës pH 6.4-9) në blistera 10 tabletash për aparatën Lovibond 2000. Në blister të jetë e shënuar data e skadencës.

18.Kyveta 10 ml (aparati Lovibond) katrore qelqi me brinjë 14 mm me lartësi 84 mm të shkallëzuara

Përsa i përket kësaj pike AK vlerëson se, në përputhje edhe me nenin 36 të LPP, për produktet e sipërcituara të ndryshohet:

Nga: Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar nga prodhuesi për shitje,tregtimin dhe suportin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara objekt i kontratës”,

Të bëhet: Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar nga prodhuesi për shitje,tregtimin dhe suportin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara objekt i kontratës”,përveç mallrave me nr.9,10,1111 dhe 18 (DPDI,DPD3, Phenol Red dhe Kyveta

10ml) të shtojcës 5 të DST të publikuara në SPE.

Në këto kushte kërkesa juaj përsa i përket këtij pretendimi duhet të pranohet.

-Në lidhje me pretendimin tuaj për artikullin 59 Letër filtri (50 cm x 50 cm)/ duhet te kete aftësi të shpejtë filtruese e gradës së katërt me masë poresh 20-25 mikron,

AK vlerëson se

Nga Letër filtri (50 cm x 50 cm)/ duhet te kete aftësi të shpejtë filtruese e gradës së katërt me masë poresh 20-25 mikron,

Të bëhet:

Letër filtri (50 cmx50cm).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, vlerësojmë se ankesa duhet të pranohet plotësisht.

II.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar ende shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit , ku të ketë pasqyruar në shtojcë ndryshimet në përputhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Almedical” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr.694/4 prot., datë 20.06.2023 protokolluar me tonën nr. 1400/2 prot., datë 22.06.2023, me objekt “Përcjellje” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Pranimi i plotë i ankimit (vendimi) Nr.694/3 prot. Datë 20.06.2023 i autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës, së operatorit ekonomik ankimues, i cili ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës duke u shprehur se: “Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ana juaj dhe kryerjes së verifikimeve të nevojshme për këtë rast, AK vendos pranimin e plotë të ankesës së bërë nga ana juaj.”

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar ende shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit , ku të ketë pasqyruar në shtojcë ndryshimet në përputhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një*

prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 pika 1 dhe 3 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr. REF-72224-06-12-2023, me objekt “Kite dhe reagente”, me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-06-2023 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën për ndryshimin e dokumentave të tenderit në përputhje me vendimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesës Nr.694/3 prot. Datë 20.06.2023, të depozituar në KPP , me nr. 1400/2023 prot., datë 19.06.2023.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesës.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri